Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 462/01
Datë: 13.11.2014

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në nenin 4 me pikat 1,3,6,9 dhe nenit 5 të pikave 1,2,3 të Rregullores së punës për Këshillin Drejtues të AKK-së, si dhe në mbështetje të nenit 14, 15, 16, 17 të kësaj rregullore, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (nr. 03- L 0600), neni 10, neni 21.3 neni 22, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 29/2014, miratuar nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritet Kombëtar i Kualifikimeve nxjerr:

VENDIM

1. Aprovohet lista dy vjeçare e eksperteve të jashtëm për procesin e akreditimit të kurseve të gjuhës angleze.
2. Aprovohet lista dy vjeçare e eksperteve të jashtëm për procesin e akreditimit të kurseve të gjuhës gjermane.
3. Aprovohet lista e ekspertëve të jashtëm per procesin e validimit të kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional nga sektori i sigurisë publike me profilin oficer doganor
4. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që varësisht nga nevojat dhe kërkesat të përzgjedhë këta ekspertë nga kjo listë dy vjeçare.
5. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka të drejtë që të plotësoj këto lista edhe pa shpallje të konkursit publik me qëllim të plotësimit të listave sipas nevojës.
6. Autoriteti Kombetar i Kualifikimeve në rast të mungesës së ekspertëve vendor do të angazhojë ekspertë ndërkombëtar për sektorin e Sigurisë publike, për profilet:
    1. Zyrtar policor i ri
    2. Zyrtar korrektues;

3. Oficer doganor
4. Zjarrfikës

7. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.
8. Vendimi të gjitha palëve të interesit.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi